



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr.117/ 2011

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga Muhamet Rexha, kryesues, Xhevdet Abazi dhe Rafet Haxhaj anëtarë, përkitazi me ankesën e Gani Elshanit kandidat për deputet nga rradhët e subjektit politik Partia Demokratike Ashkalive të Kosovës (PDAK) paraqitur kundër KQZ-së në lidhje me parregullsi të procesit të numerimit të votave në shpalljen e rezultateve përfundimtare, në seancën e mbajtur më 02.02.2011, mori:

VENDIM

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Gani Elshanit kandidat për deputet nga rradhët e subjektit politik Partia Demokratike Ashkalive të Kosovës (PDAK)

ARSYETIMI

Më datë 31.01.2011 PZAP-i ka pranuar ankesë nga Gani Elshani kandidat për deputet nga rradhët e subjektit politik PDAK ku parashtruesi kërkon “që të rregullohet numëri i ftuar i votave në nivel qendror të komunave që nuk janë shpallura me rezultatin përfundimtar nga KQZ-ja”. Më tej në ankesë potencohet se “nga të gjitha komunat nga KKZ janë marrur të gjitha votat e kandidatit, ku në listën e dytë të bashkangjitur kemi të dhënat që janë në total 827 vota, kurse sipas rezultateve të shpallura nga KQZ-ja me datën 30.01.2011 numri i votave është 384 vota përfundimtare”. Parashtruesi i ankesës kërkon që të rregullohet numëri i votave nga të gjitha komunat e Republikës së Kosovës.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, specifikon:

118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3.6, pika (c) parashohin si vijon:

3.6 (c) *Hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit*

PZAP pasi shqyrtoj dhe analizoi të gjitha shkresat e lendes gjeti se:

-ankesa është e pabazuar

Pretendimet nga parashtruesi i ankesës, se janë bërë shkeljet e potencuara në ankesë janë të pabazuara për shkak se nuk është ofruar asnjë provë zyrtare materiale si dëshmi konkrete rreth rastit në fjalë. Për më tepër në ankesë nuk është theksuar se ku mund të gjenden dëshmitë për shkeljen e supozuar, por vetëm se thuhet “i mungojnë votat”. Prandaj PZAP-i vlereson se pretendimet e parashtruesit janë të pamjaftueshme për të vertetuar faktin e pretenduar dhe duke u bazuar në keto arsye e po ashtu në pajtim me dispozitat e cituara ligjore, si dhe në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelime, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 117/2011 më datën 02.02.2011.

Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha

